




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY



Gjakovë-Djakovica-Gjakova

**Kuvendi i Komunës - Gjakovë**

01 Nr. \_\_\_\_\_ /2020

Dt. 27. 02. 2020

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, bazuar në nenin 12, nenit 51.2 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 33.2 të Statutit të Komunës së Gjakovës, në nenin 5 të Rregullores 01 nr.110/04-46963 të datës 18.12.2019, për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanime dhe Lagje Urbane në territorin e Komunës së Gjakovës, pas diskutimeve lidhur më pikën e 9-të të rendit të ditës: Formimi i Komisionit për të Udhëhequr dhe Koordinuar Punën për Zgjedhjen e Këshillave Lokal në Komunën e Gjakovës, e miratoi këtë :

### V E N D I M

#### **Për zgjedhjen e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën për zgjedhjen e këshillave lokal**

1. Themelohet Komisioni për të udhëhequr dhe koordinuar punën për zgjedhjen e Këshillave Lokal në territorin e Komunës së Gjakovës me këtë përbërje :
  1. z. Muharrem Musa , përfaqësues i Kuvendit të Komunës.
  2. z. Basri Komani, përfaqësues i Kuvendit të Komunës.
  3. z. Bashkim Gashaj , përfaqësues i Kuvendit të Komunës.
  4. z. Sali Golaj, përfaqësues i Kuvendit të Komunës.
  5. z. Flamur Fetahaj përfaqësues i Ekzekutivit .
  6. znj. Brilanda Ballata, përfaqësues e Shoqërisë Civile
  7. Një përfaqësues nga Fshati, Vendbanimi apo Lagjja Urbane .
2. Ky Komision ka për obligim që të ndjekë procedurat e parapara në Rregulloren 01 nr.110/04-46963 të datës 18.12.2019 për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Gjakovës, në mënyrë që të udhëheqë dhe koordinoi punën për zgjedhjen e këshillave lokal në Komunën e Gjakovës .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës .
4. Vendimi iu dërgohet:
  - Kryetarit të Komunës, z. Ardian Gjini
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
  - Anëtarëve të Komisionit
  - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
  - Anëtarëve të Komisionit
  - Arkivit.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z. Anton Shafa